



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.376/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Afijete Sadaj-Gllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Edona Grajçevci, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga Albert Kelani, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 421/2021 i datës 02.02.2021, për mos përfshirjen në listën përfundimtare të votuesve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14 Shkurt 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 14.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet i pasafatshëm apeli i identifikuar me numër: A.nr376/2021, i datës 12.02.2021, i parashtruar nga Albert Kelani, me të cilin ka kërkuar që të di se pse nuk është në listën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14 Shkurt 2021.

A r s y e t i m

Me datë 12.02.2021, PZAP-i ka pranuar një apel nga Albert Kelani, në të cilin parashtruesi i apelit thekson se nuk është në listën e votimeve, andaj ka kërkuar nga PZAP-i, që të di se pse nuk është në listën e votimit.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së apelit, gjeti se:

Apeli është i pasafatshëm

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të apelit, ka gjetur se apeli i parashtruar nga Albert Kelani kundër vendimit të KQZ-së, Nr.421/2021 i datës 02.02.2021, është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën 122 par.1 pika a) të LZP-së, ku përcaktohet: “*Personi fizik ose juridik, të drejtat ligjore të cilit janë prekur nga cilat do vendime të KQZ-së, mund të apelojë atë vendim në PZAP, brenda (24) orëve*”. Në këtë kuptim nga shqyrtimi i shkresave të lendes rezulton se certifikimi i listës përfundimtare të votuesve është bere me datën 02 Shkurt 2021, ndërsa parashtruesi i apelit ka apeluar vendimin e KQZ-së, me datën 12 Shkurt 2021, qe do të thotë se Vendimi i KQZ-së për Certifikimin e Listës së Votuesve, Nr. 421 është publikuar me datën 02.02.2021, ndërsa afati për ankesa ka qenë 24 (njëzetekatër) orë nga marrja e vendimit, në këtë rast apeli është parashtruar me date 12.02.2021, çka do të thotë se apeli është parashtruar pas afatit të përcaktuar në dispozitën ligjore të nenit 122 par.1 të LZP-së.

Nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 115 par.1, dhe 118 par.4 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A.nr. 376/2021 me datë 14.02.2021

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.